

20120982543

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHEM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshem pensional me financim kapital („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numer 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10 dhe 36/11), në nenin 3 paragrafi (1) pika 3) shlyhet.

Pikat 4, 5, 5-a, 6, 7, 8, 9 10, 11, 12, 13 dhe 14 behen pika 3, 4, 4-a, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Në pikën 5-a, që behet pika 5 numri "5" zëvendësohet me numrin "4".

Neni 2

Në nenet 7 paragrafi (3) dhe 98 paragrafi (1) pika v) fjalet: „pelqim paraprak” zëvendësohen me fjalet: „mendim paraprak”.

Neni 3

Në nenet 39-z paragrafi (1) dhe 133 paragrafi (1) pika 2-a pas fjales: „paragrafi” numri "(6)" zëvendësohet me numrin "(5)".

Neni 4

Në nenin 39-x paragrafet (1) dhe (2) fjalet: „me pelqimin paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” shlyhen.

Neni 5

Në nenin 46 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Agjencia është trup rregullator i pavarur dhe i mevetesishem".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Organ i Agjencisë është Këshilli i Ekspertëve".

Në paragrafin (6) fjala "Qeverisë" zëvendësohet me fjalen „Kuvendit”.

Neni 6

Neni 50 ndryshohet si vijon:

"(1) Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë përbehet nga pesë anëtarë prej të cilëve njëri është kryetar.

(2) Kryetari i Këshillit të Ekspertëve udhëheq me Agjencinë dhe e përfaqëson në marrëdhënie me persona të tretë.

(3) Kryetarin dhe katër anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë i emeron dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(4) Mandati i anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve është pesë vjet, me mundësi për rizgjedhje.

(5) Nëse procedura për emërim të anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve nuk përfundon para kalimit të mandatit të tyre, anëtarët mandati i të cilëve mbaron do të vazhdojnë ta ushtrojnë funksionin e tyre, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

(6) Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve mund të shkarkohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë edhe para mbarimit të mandatit, vetëm në rast të plotesimit të së paku njërit prej kushteve të parapara në nenin 51 paragrafi (3) të këtij ligji. Nëse anëtari i Këshillit të Ekspertëve shkarkohet para mbarimit të mandatit, në vend të tij emërohet person tjetër deri në mbarimin e mandatit të tij.

(7) Kryetari dhe dy anetaret e Keshillit të cilet në baze të propozimit të Qeverise së Republikës së Maqedonise nga paragrafi (3) i ketij neni i cakton Kuvendi i Republikës së Maqedonise, në menyre profesionale angazhohen në Agjenci me orar të plote të punes dhe nuk mund të kene funksion tjetër dhe të jene të punesuar në ndonje vend tjetër pune apo të marrin ndonje kompensim tjetër pervec rroges në pajtim me dispozitat e pergjithshme për marredhenie pune, si dhe kompensime nga honorare të perkohshem edukative dhe autoriale."

Neni 7

Neni 51 ndryshohet si vijon:

"(1) Anetar i Keshillit të Eksperteve të Agjencise mund të zgjidhet personi që i ploteson kushtet si vijojne:

- a) të jete shtetas i Republikës së Maqedonise;
- b) të kete të kryer arsim të larte dhe
- v) të jete ekspert në sferen e sigurimit pensional, ekonomise, të drejtes, supervizionit financiar, kontabilitetit, tregut të kapitalit, sigurimit dhe shkences aktuale, me pervoje pune së paku pese vjet në sferen e sigurimit pensional apo financave.

(2) Anetar i Keshillit të Eksperteve të Agjencise nuk mund të zgjidhet personi:

- a) nese i shqiptohet sanksion kundervajtes ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarise apo detyres;
- b) nese i shqiptohet denim me burg për veper penale kunder financave publike, kunder qarkullimit pagesor dhe ekonomise, kunder detyres zyrtare apo kunder komunikimit juridik;
- v) që eshte funksionar i cili udheheq me organin shteteror apo organin e administrates shteterore;
- g) që eshte anetar i organit të menaxhimit, organit mbikeqyres apo person i punesuar në shoqeri pensionale, themelues i shoqerise pensionale apo person tjetër juridik mbi të cilin supervizion kryen Agjencia;
- d) që eshte aksionar në shoqeri pensionale, themelues i shoqerise pensionale apo person tjetër juridik mbi të cilin supervizion kryen Agjencia dhe
- gj) që eshte deputet apo person që kryen detyre tjetër në të cilen eshte zgjedhur nga Qeveria apo Kuvendi i Republikës së Maqedonise.

3) Kuvendi i Republikës së Maqedonise, me propozim të Qeverise së Republikës së Maqedonise, para kalimit të mandatit për të cilin eshte zgjedhur, mund ta shkarkoje kryetarin apo anetarin e Keshillit të Eksperteve, nese:

- a) vet e kerkon kete;
- b) i hiqet aftesia e punes;
- v) nuk i respekton ndalimet nga paragrafi (6) dhe (7) të ketij neni dhe obligimet nga neni 55 i ketij ligji;
- g) pa arsye mungon në tri mbledhje të njepasnjeshme të Keshillit apo pa arsye mungon gjithsej në pese mbledhje gjate një viti;
- d) në menyre të vrazhde i shperfill detyrat e punes;
- gj) ka semundje afatgjate, e cila e pengon në kryerjen e obligimeve dhe
- e) tanime nuk i ploteson kushtet nga paragrafet (2) dhe (4) të ketij neni.

(4) Kryetari dhe anetaret e Keshillit të Eksperteve detyrohen që punen e tyre ta kryejne në menyre profesionale dhe në menyren që nuk do ta sjellin në pikepyetje pavaresine dhe mevetesine e Agjencise.

(5) Ndalohet cfaredo forme e ndikimit mbi punen e Keshillit të Eksperteve që do të mund të ndikojne mbi pavaresine dhe mevetesine e Agjencise.

(6) Personat me autorizime dhe pergjegjesi të posacme, të punesuar në Agjenci, të cilet marrin pjese në miratimin e vendimeve me ndikim të rendesishem për shoqerite pensionale, fondet pensionale dhe anetaret, duhet të kene arsim të larte dhe pervoje pune së paku tre vite në sferen e

menaxhimit me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, ekonomise, financave, kontabilitetit, investimit, sigurimit, shkences aktuale apo të drejtes. Të punesuarit në Agjenci nuk guxojne të jene anetare të organeve të shoqerive pensionale apo persona tjere juridike mbi të cilet Agjencia kryen supervizion dhe nuk guxojne të kryejne detyra individuale për keta persona juridike.

(7) Kryetari dhe anetaret e Keshillit të Eksperteve dhe të punesuarit në Agjenci gjate kohezgjatjes së mandatit të tyre, perkatesisht marredhenies së punes, nuk guxojne të pranojne cfaredo kompensimesh apo pagesash, të pranojne ndonje funksion apo punesim, apo të kryejne sherbime apo të fitojne aksione në shoqerine pensionale, themelues të shoqerise pensionale apo personit tjeter juridik mbi të cilin supervizion kryen Agjencia."

Neni 8

Neni 52 ndryshohet si vijon:

"(1) Gjate kohes së kryerjes së detyres së vet, kryetari dhe anetaret e Keshillit të Eksperteve të cilet në menyre profesionale jane të angazhuar në Agjenci me orar të plote të punes dhe të punesuarit në Agjenci, kane të drejte për rroge dhe kompensime tjera në pajtim me rregullat e pergjithshme të marredhenies së punes dhe marreveshjes kolektive.

(2) Anetaret e Keshillit të Eksperteve të cilet nuk jane të angazhuar në menyre profesionale në Agjenci, kane të drejte kompensimi mujor dhe kompensimi të shpenzimeve tjera të percaktuara me Statutin dhe aktet tjera të Agjencise.

(3) Lartesia e rrogës së kryetarit mund të jete më së shumti dy rroga mujore bruto, kurse për anetaret e Keshillit të Eksperteve të cilet në menyre profesionale jane të angazhuar në Agjenci, mund të jete më së shumti deri në një rroge e gjysme bruto të paguara në nentor në vitin paraprak në sektorin e veprimtarive financiare dhe veprimtarive të sigurimit, në pajtim me të dhenat e Entit Shteteror për Statistike. Lartesia e kompensimit mujor të anetareve të Keshillit të Eksperteve të cilet nuk jane të angazhuar në menyre profesionale në Agjenci, mund të jete më së shumti deri në gjysmen e rrogës mesatare bruto të paguar në nentor në vitin paraprak në sektorin e veprimtarive financiare dhe veprimtarive të sigurimit, në pajtim me të dhenat e Entit Shteteror për Statistike.

(4) Kryetari, anetaret e Keshillit të Eksperteve dhe të punesuarit në Agjenci kane të drejte të kryejne pune profesionale dhe shkencore, si dhe të marrin pjese në punen e shoqerive profesionale ose shkencore."

Neni 9

Pas nenit 52 shtohet neni i ri 52-a, si vijon:

"Neni 52-a

(1) Keshilli i Eksperteve të Agjencise i ka kompetencat si vijojne:

- a) e miraton Statut të Agjencise;
- b) miraton rregullore për punen e vet në pajtim me kete ligj dhe Statutin e Agjencise;
- v) miraton akt për organizim të brendshem të punes dhe sistematizim të vendeve të punes të Agjencise;
- g) miraton plan financiar dhe raporte financiare;
- d) miraton program vjetor për punen e Agjencise;
- gj) miraton raport vjetor për punen e Agjencise dhe raport vjetor për gjendjet në sigurimin pensional me financim kapital;
- e) vendos për lartesine e rrogave dhe kompensimit mujor të kryetarit dhe anetareve të Keshillit të Eksperteve;
- z) vendos për lartesine e rrogave të të punesuarve në Agjenci;

z) i vlereson të punesuarit në Agjenci një here gjate vitit në baze të ndjekjes së vazhdueshme të punes së tyre;

z) miraton akte për realizimin e të drejtave të të punesuarve të cilat dalin nga marredhenia e punes;

i) leshon, terheq dhe heq leje për themelim të shoqerive pensionale, leshon leje për kryerje të veprimtarise - menaxhim me fonde pensionale vullnetare, leje për ushtrim të veprimtarise - menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale dhe leshon, terheq dhe heq leje për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale dhe/apo fonde pensionale vullnetare;

j) jep leje dhe pelqime me kerkese nga shoqerite pensionale në baze të ligjit;

k) miraton akte për zbatim të ketij ligji dhe ligjeve tjera në kompetence të vet;

l) organizon dhe siguron kryerje ligjore të aktiviteteve nga fusheveprimi i Agjencise dhe

ll) kryen pune tjera të percaktuara me ligj dhe statut të Agjencise.

(2) Keshilli i Eksperteve vendos në mbledhje.

(3) Keshilli i Eksperteve mund të miratoje vendime në kompetence të tij nese në mbledhje jane të pranishem shumica e anetareve të tij.

(4) Vendimet e Keshillit të Eksperteve miratohen nese për to votojne shumica e anetareve të pranishem në mbledhje, me atë që kryetari dhe anetaret e Keshillit të Eksperteve nuk mund të permbahen nga votimi.

(5) Kunder vendimit të Keshillit të Eksperteve pala e pakenaqur mund të parashtroje padi për ngritje të kontestit administrativ në gjykatën kompetente. Padia nuk e prolongon miratimin e vendimit.

(6) Me perjashtim të paragrafit (5) të ketij neni, kunder vendimit të Keshillit të Eksperteve për të drejtat e marredhenies së punes vendos Komisioni Shtetror për Vendimmarrje në Procedure Administrative dhe Procedure të Marredhenies së Punes në Shkalle të Dyte.

Neni 10

Në nenin 53 paragrafi (2) fjalet: "Drejtori i Agjencise" zevendesohen me fjalet: "Kryetari i Keshillit të Eksperteve".

Në paragrafin (4) fjalet: "drejtori i Agjencise" zevendesohen me fjalet: „Kryetari i Keshillit të Eksperteve".

Neni 11

Në nenin 53-b paragrafi (2) fjala "drejtori" zevendesohet me fjalet: "Kryetari i Keshillit të Eksperteve".

Neni 12

Në nenin 54 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Agjencia parashtron raport për punen e vet për vitin paraprak për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonise, deri më 30 qershor në vitin rrjedhes."

Neni 13

Në nenin 55 paragrafi (1) fjalet: "Anetaret e Keshillit Drejtues, drejtori, zevendesdrejtori" zevendesohen me fjalet: "Kryetari dhe anetaret e Keshillit të Eksperteve".

Neni 14

Në nenin 56 paragrafet (1) dhe (2) ndryshohet si vijon:

"(1) Agjencia, më së voni deri më 31 dhjetor në vitin rrjedhes, dorezon plan financiar për vitin e ardhshem për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonise. Agjencia, më së voni deri më 30 qershor në vitin rrjedhes, dorezon raporte financiare për vitin paraprak të reviduara nga revizori i autorizuar i jashtem në pajtim me standardet nderkombetare të revizorit, në Kuvendin e Republikës së Maqedonise."

(2) Mjetet për rroge, kompensim mujor dhe kompensime tjera të Kryetarit, anetareve të Keshillit të Eksperteve dhe të punesuarve në Agjenci, sigurohen nga mjetet e Agjencise të percaktuara me planin financiar vjetor."

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"Lartesine e kompensimeve nga paragrafi (3) i ketij neni, e percakton Keshilli i Eksperteve të Agjencise, për të cilen pelqim jep Kuvendi i Republikes së Maqedonise dhe të njejtat shpallen në „Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise"."

Neni 15

Neni 57 ndryshohet si vijon:

"Agjencia, në kuader të kompetencave të saj, bashkepunon me Ministrine e Punes dhe Politikes Sociale për zhvillimin dhe permiresimin e sigurimit pensional me financim kapital."

Neni 16

Në nenin 77 paragrafi (8) fjalet: "Drejtori i Agjencise" zevendesohen me fjalet: „Kryetari i Keshillit të Eksperteve", fjalet: "ka të drejte ankese te Keshilli Drejtues i Agjencise" zevendesohen me fjalet: „mund të parashtroje padi për ngritje të kontestit administrativ te gjykata kompetente.", ndersa fjalia e trete shlyhet.

Neni 17

Në nenin 105 paragrafi (1) pika d) pas fjaleve: „Republika e Maqedonise“ shtohen fjalet: „në tregun vendor".

Neni 18

Në nenin 106 paragrafi (1) pas fjaleve: „të leshuara apo për të cilat garanton Republika e Maqedonise" shtohen fjalet: „në tregun vendor".

Neni 19

Në nenin 114 fjalet: „Ministria e Punes dhe Politikes Sociale“ zevendesohen me fjalet: "Qeveria e Republikes së Maqedonise".

Neni 20

Në nenin 130 paragrafi (2) fjalet: „Drejtori i Agjencise" zevendesohen me fjalet: "Keshilli i Eksperteve".

Në paragrafin (4) fjalet: "Drejtori i Agjencise" zevendesohen me fjalet: „Keshilli i Eksperteve".

Neni 21

Në nenin 134 paragrafi (1) pika 2 ndryshohet si vijon:

"nuk e ploteson ndonjeren nga kerkesat e parapara në nenin 21 paragrafet (1), (2), (3) dhe (4) të ketij ligji;"

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Neni 22

Keshilli i Eksperteve do të formohet në afat prej më së shumti 90 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Drejtori, zevendesdrejtori dhe anetaret e Keshillit Drejtues të Agjencise të emeruar para hyrjes në fuqi të ketij ligji, vazhdojne ta ushtrojne funksionin deri në zgjedhjen e anetareve të Keshillit të Eksperteve sipas ketij ligji.

Neni 23

Çdo ndryshim dhe plotesim të planit financiar të Agjencise për vitin 2012, Agjencia e dorezon për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 24

Statuti i Agjencise i percaktuar me kete ligj do të miratohet në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Rregullorja e punes e Keshillit të Eksperteve do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të Statutit.

Aktet për organizimin e brendshem të punes dhe sistematizimin e vendeve të punes të Agjencise, do të miratohen në afat prej gjashte muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të ketij ligji.

Deri në miratimin e rregullave nga paragrafet 1, 2 dhe 3 të ketij neni, do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 25

Shoqeria apo shoqeria për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare duhet të kryejë harmonizim të aktivitetit investues të fondit të detyrueshem pensional me të cilin menaxhon, me nenet 17 dhe 18 të ketij ligji, më së voni deri më 15 janar 2013.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në „Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.